



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.882/6 prot

Datë 29.04.2025

V E N D I M

Nr. 576/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: “Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 4,907,830 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Ankimues:

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK,
me NUIS L52122014L, me adresë: Ish Blloku i Magazinave te Tregtise, Rruga Siri Kodra, Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, me NUIS K21605003M, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe, Kashar, Tiranë

Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, me NUIS L51819005Q, me adresë: Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.03.2025, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur e thjeshtuar”*, me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: *“Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave”* me fond limit 4,907,830 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a..

II.2. Në datën 20.03.2025, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

1. “Filara shpk	2,671,470.00 Lekë, Skualifikuar
2. “ Inpress shpk	2,844,900.00 Lekë, Skualifikuar
3. “Kristalina KH” shpk	3,078,802.00 Lekë, Kualifikuar
4. “Onufri” shpk	3,287,000.00 Lekë, Kualifikuar
5. “Dhimiter Vasi” shpk	3,407,830.00 Lekë, Skualifikuar
6. “Rama Graf” shpk	3,535,550.00 Lekë, Kualifikuar
7. “Adel Co” shpk	3,748,650.00 Lekë, Kualifikuar
8. “Interlogistic” shpk	3,919,406.00 Lekë, Kualifikuar
9. “Albdesign PSP” shpk	4,019,600.00 Lekë, Kualifikuar

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“OE Inpress SHPK ka paraqitur një ofertë ekonomike anomalisht të ulët”

II.3. Në datën 28.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 03.04.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5207 dhe nr. 882/2025 protokoli, datë 03.04.2025 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur e thjeshtuar”*, me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: *“Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave”* me fond limit 4,907,830 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

I. Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

KVO e AK ka skualifikuar në mënyrë të gabuar OE Inpress shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsyet e mëposhtme:

"OE Inpress shpk., ka paraqitur një ofertë ekonomike anomalisht të ulët."

Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 4,907,830 (katër milion e nëntëqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress shpk." është në vlerën e 2,844,900 (dy milion e tetëqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është vetëm 84% (tetëdhjetë e katër përqind) e mesatares së ofertave të vlefshme.

Duke qenë se, në këtë procedurë prokuruese janë paraqitur 8 (tetë) oferta të vlefshme nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, si dhe duke pasur bindjen se ofertat ekonomike të paraqitur nga OE Interlogistic shpk. dhe Albdesign PSP shpk. janë të pavlefshme, dhe si rrjedhojë do të duhet të skualifikohen,...

...rrjedhimisht, në zbatim të nenit 93, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet: "5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët." dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet: "Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.";

...duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, Oferta e paraqitur nga OE Inpress shpk. Do të duhet të konsiderohet e rregullt dhe vlefshme nga KSHA e AK Operatori i Blerjeve të Përqendruara dhe KPP, pasi pas skualifikimit të operatorëve ekonomikë Interlogistic shpk. dhe Albdesign shpk. (ose njerit prej tyre), kjo ofertë nuk është më në kushtet e Ofertës anomalisht të ulët.

II. Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Kualifikimin e Operatorit Ekonomik "Interlogistic" shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

KVO e AK ka kualifikuar në mënyrë të gabuar OE Interlogistic shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsyet e mëposhtme:

1. Së Pari, Ne kemi bindjen, që OE Interlogistic shpk. nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 të DST, si

dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të shtojcës 8, të DST, në kundërshtim me:

Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik";

Nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik";

Pikën 1, të nenit 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohej për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm..."

Nenin 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, përcaktohet se: "...Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit..."

Nenin 26 pika 1, "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla..."

Pikën 3, të Vendimit nr. 10, datë 05.10.2022 "Për Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", të Agjencisë së Prokurimit Publik ku përcaktohet se: "3. Në çdo set të DST për mallra, punë, shërbime ndryshohet "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve, për këtë lloj procedure"...

...Konkretisht, mendojmë se OE Interlogistic PSP shpk. ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai I publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Mendojmë, se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i ngarkuar nga OE Interlogistic shpk. në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, dhe rrjedhimisht OE Interlogistic shpk. nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 2.1.a. "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të DST.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me dispozitat e sipërcituara ligjore dhe nëligjore të prokurimit publik, si dhe në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit, si çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të duhet të refuzohet. Ne kemi bindjen që, në rastin konkret, OE Interlogistic shpk, nuk ka ofertuar sipas shtojcës 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Për referencë, këtu do të donim të nënvizonim, se të njejtin qëndrim sa më sipër, ka mbajtur vetëm pak kohë më parë edhe Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Vendimit të tij, Nr. 183/2023, datë 09.03.2023, me anë të së cilës shprehet qartësisht dhe saktësisht në lidhje me këtë pikë.

Referuar sa më sipër, gjykojmë, se OE Interlogistic shpk. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur shtojcën 9 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pjesë e dokumentave të tenderit, dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet.

Rrjedhimisht, OE Interlogistic shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

2. Së dyti, operatori ekonomik "Interlogistic", NUK ka asnjë eksperiencë / punë të ngjashme për pjesën më të madhe të "shërbimeve" që kërkohen në DST
[...]

Sic mund të vihet re lehtësisht, OE Interlogistic shpk. nuk ka asnjë punë dhe eksperiencë të ngjashme për shërbimet e kërkuara në pikat 13, 14, 15, 16, 17, të shtojcës 6, të DST, ku kërkohet shërbimi I botimit / publikimit dhe prodhimit të librave, revistave dhe broshurave.

OE Interlogistic shpk. është botërisht e ditur që është një shoqëri tregtare tregtuese e mallrave kancelarike, dhe rrjedhimisht mund të ketë punë të ngjashme për furnizimin e "mallrave" kancelarike, apo kancelarike me bazë letre, sic mund të jenë: regjistra, kuti, libra poste etj.

Por kurrësesi, OE Interlogistic shpk. nuk mund të ketë eksperiencë / punë të ngjashme në dhënien e shërbimeve të botimit / publikimit dhe prodhimit të librave, revistave dhe broshurave.

OE Interlogistic shpk. nuk është as shtypshkronjë dhe as shtëpi botuese, e cila mund të mundësojë realizimin me sukses të "shërbimit" të botimit / publikimit dhe prodhimit të librave, revistave dhe broshurave.

Procedura prokuruese është e llojit "shërbim", rrjedhimisht operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë eeksperienca / punë të ngjashme në dhënien e shërbimit të printimit, shtypshkrimit të botimeve dhe publikimeve. Shërbime të cilat OE Interlogistic shpk. nuk mund ti ofrojë kurrësesi, pasi nuk ka asnjë eksperincë dhe punë të ngjashme. Por mbi të gjitha nuk është as shtëpi botuese dhe as shtypshkronjë.

Referuar sa më sipër, gjykojmë, se OE Interlogistic shpk. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2.3, "Kapaciteti teknik", i shtojcës 9, të DST, pasi nuk ka paraqitur dhe nuk ka asnjë punë / eksperincë të ngjashme për ofrimin e pjesës dërrmuese të shërbimeve të kërkuara në DST, dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet.

Rrjedhimisht, OE Interlogistic shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

* * *

3. Së treti, Ne kemi bindjen, që në kundërshtim me pikën 2.3.3, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të shtojcës 9, të DST, OE Interlogistic shpk. NUK ka në stafin e tij ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, "Dizajner". Si dhe në stafin e tij, NUK ka asnjë personel të regjistruar në listëpagesa me kodin "Dizajner".

Në pikën 2.3.3, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të shtojcës 9, të DST, përcaktohet: "2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 1 (një) punonjës ndihmës,
- d) 1 (një) shofer.

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;

- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,

- Leje drejtimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

Nisur nga fakti, se OE Interlogistik shpk. është një shoqëri tregtare, furnizuese e artikujve / mallrave kancelarikë, pra një shoqëri tregtare që furnizon malltra, dhe NUK ofron shërbime, ne kemi bindjen që ky operator ekonomik nuk disponon në stafin e tij personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, ”Dizajner”. Si dhe në stafin e tij, NUK ka asnjë personel të regjistruar në listëpagesa me kodin “Dizajner”.

Gjithashtu, do të donim të parashtrojmë, se stafi / personeli teknik, i deklaruar nga OE Interlogistic shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar.”

Rrjedhimisht, OE Interlogistic shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

* * *

4. Së katërti, Në kundërshtim me pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ku përcaktohet se:

“2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- ☐ Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 1 (një) copë
- ☐ Makinë qepëse 1 (një) copë
- ☐ Makinë telefoni; 1 (një) cope

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari,

përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

Ne shprehim bindjen tonë, që OE Interlogistic shpk. NUK disponon asnjë prej makinerive / pajisjeve të kërkuara në DST.

Gjithashtu, ne kemi bindjen se Dokumentacioni i paraqitur NUK përmban të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Sie theksuam edhe mësipër, OE Interlogistic shpk. NUK është një shtypshkronjë, dhe rrjedhimisht nuk mund të disponojë makineri / pajisje shtypshkrimi.

Në lidhje me këtë pikë, bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe pikës 2.3.2. “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ku përcaktohet se: “Dokumentacioni I paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara....”

...Kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë pikë të ankesës, të verifikojnë zyrtarisht disponimin e këtyre makinerive / pajisjeve pranë ambjenteve të OE Interlogistic shpk.

Referuar sa më sipër, gjykojmë, se OE Interlogistic shpk. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2.3.2, “Kapaciteti teknik”, i shtojcës 9, të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm me anë të së cilës të provojë disponimin e makinerive / pajisjeve të kërkuara në DST, si dhe nuk disponon asnjë prej pajisjeve të kërkuara në DST, dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet.

Rrjedhimisht, OE Interlogistic shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

** * **

5. Së pesti, Mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Interlogistic shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe një informacion nga OE Interlogistic shpk.

Gjithashtu, mendojmë që OE Interlogistic shpk., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, për të gjitha kontratet e vlefshme që ky operator ekonomik ka me OSHEE Group sh.a. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe një informacion nga OE Interlogistic shpk.

Rrjedhimisht, OE Interlogistic shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

III. Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Kualifikimin e Operatorit Ekonomik “Albdesign PSP” shpk., Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

1. Së Pari, Ne kemi bindjen, që OE Albdesign PSP shpk. nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 të DST, si dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. ”Kriteret e Veçanta të Kualifikimit“, të shtojcës 8, të DST, në kundërshtim me:

Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;

Pikën 1, të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm...”

Nenin 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “...Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit...”

Nenin 26 pika 1, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet

publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla...”;

Pikën 3, të Vendimit nr. 10, datë 05.10.2022 “Për Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, të Agjencisë së Prokurimit Publik ku përcaktohet se: “3. Në çdo set të DST për mallra, punë, shërbime ndryshohet “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve, për këtë lloj procedure”...

...Konkretisht, mendojmë se OE Albdesign PSP shpk. ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai I publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Mendojmë, se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i ngarkuar nga OE Albdesign PSP shpk. në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, dhe rrjedhimisht OE Albdesign PSP shpk. nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 2.1.a. “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të DST.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me dispozitat e sipërcituara ligjore dhe nëligjore të prokurimit publik, si dhe në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit, si çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të duhet të refuzohet. Ne kemi bindjen që, në rastin konkret, OE Albdesign PSP shpk, nuk ka ofertuar sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Për referencë, këtu do të donim të nënvizonim, se të njejtin qëndrim sa më sipër, ka mbajtur vetëm pak kohë mëparë edhe Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Vendimit të tij, Nr. 183/2023, datë 09.03.2023, me anë të së cilës shprehet qartësisht dhe saktësisht në lidhje me këtë pikë.

Referuar sa më sipër, gjejkojmë, se OE Albdesign PSP shpk. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur shtojcën 9 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pjesë e dokumentave të tenderit, dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet.

Rrjedhimisht, OE Albdesign shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

2. Së dyti, Ne kemi bindjen, që OE Albdesign PSP shpk. do të duhet të skualifikohet në zbatim të Nenit 76, pika 3/h, të të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “h. operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.”,... ...pasi, ky operator ekonomik nuk respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Për sa mësipër, i kërkojmë KSHA së AK OBP dhe Komisionit të Prokurimit Publik, që përpara se të marrë një vendim në lidhje me ankesën objekt shqyrtimi, të bëjë verifikime të mëtejshme dhe ti kërkojë me shkrim informacion zyrtar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), nëse OE Albdesign PSP shpk. i respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, apo jo...???

Referuar sa më sipër, gjykojmë, se OE Albdesign PSP shpk. do të duhet të skualifikohet, në zbatim të Nenit 76, pika 3/h të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 1/k, të shtojcës 8 “Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit”, pasi në kemi bindjen se OE Albdesign PSP shpk. nuk respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Së treti, Operatori ekonomik Albdesign PSP shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.,

Në pikën 2.3.3. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 9, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet:

“2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

e) 1 (një) përgjegjës shërbimi,

f) 1 (një) punonjës grafik- dizajner

g) 1 (një) punonjës ndihmës,

h) 1 (një) shofer.

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;

- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,

- Leje drejtimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

Ne kemi bindjen që OE Albdesign PSP shpk. nuk disponon të gjithë personelin teknik të nevojshëm, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST dhe konkretisht NUK disponon: 1 (një) përgjegjës shërbimi, dhe 1 (një) punonjës grafik- dizajner.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Albdesign PSP shpk. nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST.

Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik, i deklaruar nga OE Albdesign PSP shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar.”

Rrjedhimisht, përsa i përket këtij kriteri teknik / profesional. bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Albdesign PSP shpk do të duhet të skualifikohet.

** * **

4. Së katërti, Mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Albdesign PSP shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, mendojmë që OE Albdesign PSP shpk., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike.

Rrjedhimisht, OE Albdesign PSP shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, pasi të kryejnë verifikimet e kërkuara të duhura, do të duhet të:

- Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Operatori i Blerjeve të Përqendruara;*
- Skualifikojë OE Interlogistic shpk.;*
- Skualifikojë OE Albdesign PSP shpk.;*

- Kualifikojë OE Inpress shpk.;
- ...si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik "Inpress" shpk."

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 882/1 Prot., datë 04.04.2025.

II.6. Në datën 10.04.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 882/2 prot., vendimi i KSHA-së nr.19/2025, datë 09.04 2025, ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike. Në datën 11.04.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 882/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 789/7 prot., datë 10.04.2025 me objekt: "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga "Inpress" SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit nr. REF-39999-03-05-2025, me objekt: "Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave", bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr.19/2025, datë 09.04 2025. Referuar vendimit të KSHA-së rezultoi se ankesa e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK është refuzuar.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK se: "OE Inpress SHPK ka paraqitur një ofertë ekonomike anomalisht të ulët", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet se: "1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, pika 4,parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga

ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.3. Referuar ankesës së paraqitur, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: “Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 4,907,830 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, kanë ofertuar 9 operatorë ekonomikë nga të cilët 8 prej tyre rezultojnë se *përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme* në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi KVO-ja ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST.

Në rastin në fjalë janë të vlefshme tetë oferta (përfshirë këtu ofertat e shoqërive “Filara” SHPK dhe “Inpress” SHPK, të refuzuara nga KVO-ja si oferta anomalisht të ulta) dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nga përlllogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK në vlerën prej 2.844.900 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në

kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit.

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: “*Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave*” e ka fondin limit 4,907,830 lekë, vlerë e cila rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar nenit 11 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku thuhet se: *Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:*

a) *Kufiri i lartë monetar:*

- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) *Kufiri i ulët monetar:*

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së për refuzimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK është i drejtë, pasi në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor i refuzon ofertat, të cilat rezultojnë anomalisht të ulta, pa kërkuar shpjegime.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-39999-03-05-2025 me objekt: “Shërbime printimi, materiale shtypshkrime për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 4,907,830 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

